

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË**  
**Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve**

**SKELETKURRIKULI**

**Për Drejtimin Mësimor**

**HOTELERI - TURIZËM**

**Niveli IV i KSHK**

**(1 vjeçar)**

**Kodi: G-IV-21**

Miratoi:

MINISTRI

**Tiranë, 2021**

## **Përmbajtja:**

- I. Qëllimet e arsimit profesional në drejtimin “Hoteleri-turizëm”, niveli IV i Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK).**
- II. Profili profesional i nxënësve në përfundim të arsimit profesional në drejtimin “Hoteleri-turizëm”, niveli IV i KSHK.**
  1. Kërkesat e pranimet të nxënësve në arsimin profesional në drejtimin “Hoteleri-turizëm”, niveli IV i KSHK.
  2. Kompetencat e përgjithshme të nxënësve në përfundim të arsimit profesional në drejtimin “Hoteleri-turizëm”, niveli IV i KSHK.
  3. Kompetencat profesionale të nxënësve në përfundim të arsimit profesional në drejtimin “Hoteleri-turizëm”, niveli IV i KSHK.
  4. Mundësitë e punësimit dhe të arsimimit të mëtejshëm në përfundim të arsimit profesional në drejtimin “Hoteleri-turizëm”, niveli IV i KSHK.
- III. Plani mësimor për drejtimin “Hoteleri-turizëm”, niveli IV i KSHK.**
- IV. Udhëzime për planin mësimor.**
- V. Udhëzime për procesin mësimor.**
- VI. Udhëzime për vlerësimin dhe provimet.**
- VII. Të dhëna për certifikatën që fitohet në përfundim të arsimit profesional në drejtimin “Hoteleri-turizëm”, niveli IV i KSHK.**
- VIII. Programet e përgjithshme të lëndëve teorike profesionale.**
- IX. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale të detyruar.**

## **I. Qëllimet e arsimit profesional në drejtimin “Hoteleri-turizëm”, niveli IV i KSHK.**

Qëllimi kryesor i arsimit profesional në drejtimin “Hoteleri-turizëm”, niveli IV i KSHK, është *“zhvillimi i personalitetit të nxënësve për të jetuar në përshtatje me botën që i rrethon dhe përgatitja e tyre për t’u punësuar në veprimtaritë profesionale që lidhen drejtpërdrejt me shërbimet në industrinë e hotelerisë dhe turizmit, si dhe për të vijuar arsimin dhe formimin në nivele më të larta”*. Për të realizuar këtë, shkolla profesionale u krijon nxënësve:

- mundësi të përshtatshme për të nxënë, pavarësisht nga gjinia, raca, besimi dhe aftësitë;
- mundësi për të gjithë, për të zhvilluar kompetencat profesionale, të bazuara në njohuritë, shprehitë, qëndrimet dhe vlerat, të mjaftueshme për të lehtësuar punësimin dhe përparimin drejt formimit profesional dhe arsimit të mëtejshëm;
- mbështetje për t’u njohur me parimet e zhvillimit të qëndrueshëm, me rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe për t’i zbatuar ato me rreptësi;
- mbështetje për t’u njohur me teknologjitë e proceset teknologjike bashkëkohore e të perspektivës, që lidhen me kualifikimin profesional përkatës;
- mbështetje për të zhvilluar ndjenjën e disiplinës, kuriozitetin intelektual dhe profesional, aftësitë sipërmarrëse dhe menaxhuese, si dhe vlerat morale;
- mbështetje për t’u zhvilluar psikologjikisht dhe fizikisht, për të përballuar vështirësitë që do të ndeshin gjatë veprimtarive të ardhshme profesionale dhe akademike;
- mbështetje për të zhvilluar frymën e tolerancës e të mirëbesimit përmes përvojës së punës.

## **II. Profili profesional i nxënësve në përfundim të arsimit profesional në drejtimin “Hoteleri-turizëm”, niveli IV i KSHK.**

### **1. Kërkesat e pranimit të nxënësve në arsimin profesional në drejtimin “Hoteleri-turizëm”, niveli IV i KSHK.**

Në shkollat që ofrojnë arsimin profesional në drejtimin “Hoteleri-turizëm”, niveli IV i KSHK, kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë të rinjtë që:

- kanë mbaruar arsimin profesional në një nga profilet e nivelit III të drejtimin mësimor “Hoteleri-turizëm”;
- janë të aftë fizikisht dhe mendërisht të përballojnë kërkesat e këtij niveli të arsimit profesional;
- kanë aftësi të kufizuara, por për të cilët shkolla krijon kushte dhe përshtat programin në përputhje me paaftësitë që shfaqin;

Në raste të veçanta kur kërkesat për të ndjekur këtë shkollim janë më të larta se kapacitetet reale të këtyre shkollave, atëherë, MFE përgatit udhëzime të veçanta me kritere të posaçme pranimi për këto shkolla.

### **2. Kompetencat e përgjithshme të nxënësve në përfundim të arsimit profesional në drejtimin “Hoteleri-turizëm”, niveli IV i KSHK.**

Në përfundim të arsimit profesional në drejtimin “Hoteleri-turizëm”, niveli IV i KSHK, nxënësi do të zotërojë këto kompetenca të përgjithshme kryesore:

- Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme.

- Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional.
- Të nxisë potencialin e tij të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më eficiente.
- Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror.
- Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integriteteve lokale, rajonale dhe ndërkombëtare.
- Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse e menaxhuese për të ardhmen e tij.
- Të tregojë vetëkontroll dhe përshtatshmëri gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij.
- Të organizojë drejt procesin e të nxënësve të tij dhe të shfaqë gadishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës.
- Të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuar.
- Të vlerësojë dhe vetvlerësojë nisur nga kritere të drejta si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij.

### **3. Kompetencat profesionale të nxënësve në përfundim të arsimit profesional në drejtimin “Hoteleri-turizëm”, niveli IV i KSHK.**

Në përfundim të arsimit profesional në drejtimin “Hoteleri-turizëm”, niveli IV i KSHK, nxënësi do të jetë i aftë të zhvillojë më tej kompetencat profesionale të fituara në njërin nga profilet mësimore të nivelit III të KSHK, si dhe të ushtrojë kompetenca të tjera profesionale, si më poshtë:

- Të fitojnë aftësitë themelore dhe teknikat për të udhëhequr dhe menaxhuar një biznes në kontekst të kërkesave aktuale shoqërore.
- Të hartojë një plan-biznesi për strukturat hoteliere dhe turistike.
- Të analizojë rolin e elementëve të potencialeve turistike në zhvillimin e turizmit në rajon dhe në botë.
- Të analizojë pasojat dhe efektet gjeografike të turizmit në rajon dhe në botë.
- Të analizojë rëndësinë e zhvillimit të turizmit të qëndrueshëm, ruajtjes së mjedisit si dhe sfidat në zbatimin e menaxhimit të qëndrueshmërisë dhe mbrojtjen e ekosistemit, duke mbajtur parasysh legjislacionin respektiv.
- Të analizojë tregun turistik (tregun e produkteve, kërkesën, ofertën turistike dhe sjelljen konsumatore).
- Të analizojë efektet e zhvillimit të turizmit në makroekonominë e një vendi.
- Të analizojë të drejtat dhe detyrimet që duhet të zbatohen ofruesit dhe konsumatorët në industrinë turistike, pasqyruar kjo në legjislacionin kombëtar dhe ndërkombëtar.
- Të interpretojë format e garantimit të cilësisë dhe legjislacionin përkatës në turizëm, sipas standardeve të kërkuara.
- Të vlerësojë rezultatet e pasqyrave financiare (bilanci, pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve), si matës të suksesit të strukturës hoteliere dhe turistike.
- Të vlerësojë llogaritjen e kostove, me qëllim menaxhimit efektiv të burimeve njerëzore, materiale dhe financiare në hoteleri-turizëm.
- Të zbatojë bazën ligjore që i referohet veprimtarive profesionale në hoteleri-turizëm si dhe marrëdhënieve me shtetin (taksa e tatime, deklaratave tatimore etj.)
- Të zbatojë standartet teknike të profesionit në hoteleri-turizëm.
- Të zbatojë parimet e etikës gjatë veprimtarive profesionale në hoteleri-turizëm.
- Të hartojë ofertën e ushqimit dhe pijeve, sipas llojeve të aktiviteteve dhe eventeve.

- Të hartojë programe dhe produkte turistike, sipas kërkesave të tregut turistik.
- Të përdorë teknologjinë e informimit dhe komunikimit për qëllime të profesionit në hoteleri-turizëm (programe përkatëse kompjuterike për menaxhimin e aktivitetit në strukturat hoteliere dhe turistike).
- Të përdorë dhe mirëmbajë veglat, pajisjet dhe materialet e punës gjatë aktivitetit në strukturat hoteliere dhe turistike.
- Të kryejë saktë veprimet kryesore për të dhënë ndihmën e shpejtë gjatë punës në strukturat hoteliere dhe turistike.
- Të zbatojë rregullat e sigurisë në punë dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë punës në strukturat hoteliere dhe turistike.

#### 4. Mundësitë e punësimit dhe të arsimimit të mëtejshëm në përfundim të arsimit profesional në drejtimin “Hoteleri-turizëm”, niveli IV i KSHK.

Përfundimi me sukses i arsimit profesional në drejtimin “Hoteleri-turizëm”, niveli IV i KSHK, e pajis nxënësin me Diplomën e Maturës Shtetërore Profesionale, si dhe me Certifikatën e menaxherit në fushën e hoteleri-turizmit. Ky kualifikim i jep nxënësit mundësinë që t’i drejtohet tregut të punës për punësim në sektorin e akomodimit, në bizneset e ushqimit dhe pijeve, në agjencitë e udhëtimit dhe ato turistike, si dhe në të gjithë sektorët dhe bizneset që ofrojnë shërbime të akomodimit, ushqimit, pijeve, argëtimit dhe eventeve. Me përfundimin e këtij niveli, nxënësi ka mundësi për vazhdimin e arsimit në nivelin pas të mesëm ose në nivelin e studimeve universitare.

### III. Plani mësimor për drejtimin “Hoteleri-turizëm”, niveli IV i KSHK.

Plani mësimor për drejtimin “Hoteleri-turizëm”, niveli IV i KSHK.			
Nr	Kodi	Lëndët dhe modulet mësimore	Orët javore/vjetore
			Klasa 13
<b>A.</b>		<b>Lëndët e përgjithshme</b> (Gjithsej)	<b>15/16</b> (480/512)
1		Gjuhë shqipe	1
2		Letërsi	1
3		Gjuhë e huaj e parë	2
4		Gjuhë e huaj e dytë (me zgjedhje të lirë)	(1)
5		Matematikë	2
6		Fizikë	1
7		Biologji	2
8		Shkenca sociale	1
9		Histori	1
10		Gjeografi	1
11		TIK	1
12		Edukim fizik, sporte, shëndet	2
<b>B.</b>		<b>Lëndët profesionale</b> (Gjithsej)	<b>9</b> (288)
1	L-17-197-20	Bazat e sipërmarrjes	2
2	L-05-198-12	Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm	1

3	L-13-296-12	Gjeografi turistike	2
4	L-13-297-20	Ekonomi e turizmit	2
5	L-17-298-20	Kontabilitet	2
<b>C.</b>		<b>Module të detyruar të praktikës profesionale (Gjithsej)</b>	<b>6 (192)</b>
1	M-13-855-20	Krijimi dhe organizimi i strukturës hoteliere dhe turistike	33
2	M-17-1656-20	Veprime të blerjes dhe të shitjes në treg	33
3	M-13-1657-20	Oferta e produkteve dhe shërbimeve në strukturën hoteliere dhe turistike	33
4	M-13-1658-20	Menaxhimi i personelit në strukturën hoteliere dhe turistike	30
5	M-17-1659-20	Kontabilizime të thjeshta në strukturën hoteliere dhe turistike	30
6	M-13-1660-20	Promocioni i produktit dhe i imazhit të strukturës hoteliere dhe turistike	33
		<b>Gjithsej A+B+C</b>	<b>30/31 (960/ 992)</b>

#### IV. Udhëzime për planin mësimor

Në klasën 13, viti shkollor ka gjithsej 36 javë (32 javë mësimore + 4 javë provime).

Një javë mësimore ka jo më shumë se 31 orë mësimore (teorike dhe praktike).

Një orë mësimore zgjat 45 minuta.

Kurrikuli i arsimit profesional në drejtimin “Hoteleri-turizëm”, niveli IV i KSHK, përbëhet nga 3 grupe elementesh kurrikulare:

- Lëndët e kulturës së përgjithshme, të përbashkëta për drejtimet e ndryshme të këtij niveli (programet e detajuara të tyre jepen në një dokument të veçantë të MASR).
- Lëndët e kulturës profesionale (programet e përgjithshme janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).
- Modulet e praktikave profesionale të detyruara (përshkruesit e tyre janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).

Rekomandohet që modulet e praktikës profesionale të realizohen në ndarje ditore 3 orëshe ose 6 orëshe.

#### V. Udhëzime për procesin mësimor.

Mësuesit e lëndëve teorike profesionale dhe instruktorët e moduleve të praktikave profesionale duhet të përzgjedhin dhe përdorin forma dhe metoda mësimdhënieje të tilla që të nxisin maksimalisht të nxënësit aktiv të nxënësve dhe të çojnë në krijimin e ta, të kompetencave profesionale dhe menaxheriale, të plota dhe të qëndrueshme.

E rëndësishme është që *planifikimi i mësimdhënies* të bazohet në një proces analize fillestare, i cili të marrë parasysh faktorë të tillë të rëndësishëm si, niveli i hyrjes së nxënësve, përmbajtja e hollësishme e lëndëve profesionale dhe e moduleve të praktikave profesionale të parashikuara dhe shkalla e integritit të tyre, objektivat konkretë që do të arrihen, mundësitë reale që ka shkolla për realizimin e veprimtarive mësimore etj. Për këtë planifikim duhet një bashkëpunim i ngushtë i të gjithë personelit mësimdhënës dhe drejtues të shkollës.

Elementi kyç për arritjen e suksesit në një proces të nxëni, është *motivimi i nxënësve*. Njohja

e vazhdueshme e nxënësve me shkallën e përmbushjes së objektivave nga ana e tyre përbën një mekanizëm të fuqishëm motivimi, i cili duhet të shihet me përparësi nga mësuesit.

Një element tjetër që ndihmon suksesin është *integrimi i teorisë me praktikën* e profesionit. Parimi i “të nxënësve duke bërë” duhet të gjejë vendin e duhur në procesin e të mësuarit në shkollat profesionale të drejtimit mësimor “Hoteleri-turizëm”, niveli IV i KSHK.

Mësuesit dhe instruktorët duhet të përdorin metoda të tilla të të mësuarit që zhvillojnë jo vetëm njohuritë teorike, shkathhtësitë dhe shprehitë praktike të nxënësve, por edhe qëndrimet e tyre ndaj jetës, punës dhe shoqërisë në përgjithësi. *Puna në grup* dhe *Puna me projekte* janë dy nga format bazë të organizimit të mësimit (teorik ose praktik) për të zhvilluar *kompetencat kyçe*, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve që kanë të bëjnë me veprimtarinë profesionale në veçanti dhe jetën e profesionistit të ardhshëm, në përgjithësi. Rekomandohet përdorimi i metodës së “*lojës me role*”, ku nxënësve t’u jepen përgjegjësi në kryerjen e funksioneve menaxhuese dhe drejtuese.

Një parim tjetër që duhet respektuar nga mësuesit dhe instruktorët është fakti që *të nxënësve nuk ndodh vetëm në mjediset e shkollës, por edhe jashtë tyre*. Dhënia e detyrave dhe puna kërkimore e pavarur e nxënësve ka një ndikim të dukshëm në formimin e tyre si profesionistë të ardhshëm të drejtimit profesional “Hoteleri-turizëm”.

Në rastin e nxënësve me aftësi të kufizuara, mësuesit duhet të përshtasin programet e lëndëve dhe përshkruesit e moduleve në përputhje me mundësitë e tyre, si dhe të krijojnë kushte për zbatimin e tyre.

## **VI. Udhëzime për vlerësimin dhe provimet përfundimtare.**

Vlerësimi vjetor i nxënësve në lëndët teorike profesionale dhe modulet e praktikave profesionale bëhet nga vetë mësuesit dhe instruktorët përkatës, me metoda dhe instrumente vlerësimi të përgatitura ose përzgjedhura nga vetë ata. Vlerësimi i nxënësve të bëhet me nota (4-10) si për lëndët teorike, ashtu edhe për modulet praktike, si gjatë vitit, ashtu edhe në provimet përfundimtare.

Në përfundim të klasës së 13-të, nxënësi i arsimuar në drejtimin mësimor “Hoteleri-turizëm”, niveli IV i KSHK, i nënshtrohet provimeve të Maturës Shtetërore Profesionale (sipas udhëzimeve të MASR dhe MFE) si dhe Provimit të Praktikës Profesionale të Integruar (sipas udhëzimeve të MFE).

## **VII. Të dhëna për certifikatën që fitohet në përfundim të arsimit profesional në drejtimin mësimor “Hoteleri-turizëm”, niveli IV i KSHK.**

Me përfundimin e suksesshëm të arsimit profesional në drejtimin mësimor “Hoteleri-turizëm”, niveli IV i KSHK, shkolla profesionale e pajis nxënësin me Diplomën e Maturës Shtetërore Profesionale, si dhe me Certifikatën e menaxherit në sektorin e hoteleri-turizmit, të cilat njihen në territorin e Republikës së Shqipërisë. Sipas modeleve të miratuara nga MFE, këto dëshmi përmbajnë:

a) Të dhënat për nxënësin, shkollën, vitin e përfundimit, kualifikimin e fituar, etj.

b) Të dhëna për rezultatet e arritura nga nxënësi:

- rezultatet në lëndët e përgjithshme, lëndët profesionale dhe modulet profesionale të klasës 13-të;

- rezultatet e provimeve të Maturës Shtetërore Profesionale dhe të Praktikës Profesionale të Integruar.

## VIII. Programet e përgjithshme të lëndëve teorike profesionale.

### 1. Lënda “Bazat e sipërmarrjes” (L-17-197-20), kl. 13 – 64 orë

- Synimet e lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl. 13.

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl.13, nxënësit duhet:

- të analizojnë veçoritë e etikës dhe komunikimit në kontekstin e veprimtarisë së bizneseve
- të bëjnë vlerësimin e mundësive dhe rreziqeve në kontekstin e konceptimit të idesë së biznesit
- të përshkruajnë rëndësinë dhe strukturën e një plani biznesi
- të zbatojnë procedurat e regjistrimit dhe përshkruajnë fazat e zhvillimit të biznesit
- të konceptojnë strukturën organizative dhe përshkrimet e punës së personelit të një biznesi
- të përshkruajnë veçoritë e planifikimit, rekrutimit, seleksionimit dhe zhvillimit të burimeve njerëzore të një biznesi
- të analizojnë aspektet e buxhetimit të një biznesi
- të kryejnë llogaritje ekonomike në kuadrin e kontabilitetit financiar të një biznesi
- të llogarisin kostot dhe çmimet e produkteve e shërbimeve të një biznesi
- të analizojnë aspektet e marketingut dhe teknikat e shitjeve në një biznes
- të analizojnë rolin dhe teknikat e e-sipërmarrjes në veprimtarinë e bizneseve.
- të përshkruajnë dhe simulojnë veprimet individuale me bankat, në lidhje me llogaritë, transfertat, kreditë dhe investimet.
- të analizojnë llojet e siguracioneve personale dhe veprimet që kryhen me to.

- Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl.13 - 64 orë

<b>Tema 1</b>	Etika dhe komunikimi në biznes	4 orë
<b>Tema 2</b>	Konceptimi i idesë së biznesit, vlerësimi i mundësive dhe rreziqeve	6 orë
<b>Tema 3</b>	Hartimi i planit të biznesit	6 orë
<b>Tema 4</b>	Procedurat e regjistrimit të biznesit	6 orë
<b>Tema 5</b>	Struktura organizative dhe personeli i biznesit	5 orë
<b>Tema 6</b>	Planifikimi, rekrutimi, seleksionimi dhe zhvillimi i burimeve njerëzore	6 orë
<b>Tema 7</b>	Kostimi dhe çmimi i produkteve dhe shërbimeve	4 orë
<b>Tema 8</b>	Kontabiliteti financiar në kuadrin e biznesit	6 orë
<b>Tema 9</b>	Buxheti në biznes	4 orë
<b>Tema 10</b>	Marketingu dhe shitjet në biznes	9 orë
<b>Tema 11</b>	E – sipërmarrja	2 orë
<b>Tema 12</b>	Veprimet individuale me bankat	3 orë
<b>Tema 13</b>	Siguracionet personale	3 orë



## 2. Lënda “Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm” (L-05-198-12), kl.13 – 32 orë

### • Synimet e lëndës “Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm”, kl. 13

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm”, kl.13, nxënësit duhet:

- Të shpjegojnë kuptimin për “mjedisin” dhe “mbrojtjen e mjedisit”.
- Të shpjegojnë kuptimin për “zhvillimin e qëndrueshëm”.
- Të tregojnë sesi ndikon veprimtaria e njeriut në mjedisin rrethues
- Të përshkruajnë burimet kryesore të mjedisit jetësor.
- Të analizojnë marrëdhëniet midis zhvillimeve demografike dhe mjedisit jetësor.
- Të tregojë dhe japin shembuj të ndikimit të mbetjeve në mjedisin jetësor.
- Të përshkruajnë mekanizmat e monitorimit të burimeve mjedisore.
- Të përshkruajnë kuadrin ligjor dhe institucional ndërkombëtar, kombëtar dhe vendor në lidhje me mjedisin dhe zhvillimin e qëndrueshëm.
- Të përshkruajnë sistemet e menaxhimit të mjedisit.
- Të hulumtojnë dhe analizojnë problemet mjedisore në mjedisin vendor.
- Të planifikojnë dhe realizojnë veprimtari praktike për mbrojtjen e mjedisit vendor.

### • Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm”, kl.13 - 32 orë

<b>Tema 1</b>	Njohuri të përgjithshme për mjedisin dhe zhvillimin e qëndrueshëm	2 orë
<b>Tema 2</b>	Burimet kryesore të mjedisit dhe degradimi mjedisor	3 orë
<b>Tema 3</b>	Ndikimi i veprimtarisë së njeriut në mjedis.	3 orë
<b>Tema 4</b>	Zhvillimet demografike dhe mjedisi	3 orë
<b>Tema 5</b>	Shoqëria e konsumit dhe mbetjet	4 orë
<b>Tema 6</b>	Monitorimi i burimeve mjedisore	3 orë
<b>Tema 7</b>	Kuadri ligjor dhe institucional për mjedisin dhe zhvillimin e qëndrueshëm.	2 orë
<b>Tema 8</b>	Sistemet e menaxhimit të mjedisit	3 orë
<b>Tema 9</b>	<u>Veprimtari praktike</u> për analizën e problemeve dhe planifikimin e nismave mjedisore në nivel lokal.	3 orë
<b>Tema 10</b>	<u>Veprimtari praktike</u> për mbrojtjen e mjedisit lokal	6 orë

## 3. Lënda “Gjeografi turistike” (L-13-296-12). Kl. 13 – 64 orë

### • Synimet e lëndës “Gjeografi turistike”, kl. 13.

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Gjeografi turistike”, kl.13, nxënësit duhet:

- Të shpjegojnë kuptimin dhe rëndësinë e gjeografisë turistike
- Të evidentojnë veçoritë e studimit të turizmit nga këndvështrimi gjeografik.
- Të vlerësojnë dhe analizojë elementët natyrorë si bazën e potencialit turistik të një rajoni.
- Të evidentojnë rolin që ka relievi, klima, uji, flora dhe fauna në zhvillimin e turizmit.
- Të evidentojnë zonat klimatike, ku është i përhapur turizmi balnear dhe turizmi i bardhë.
- Të dallojë harmoninë mes turizmit dhe mjedisit natyror, ku zhvillohet ky turizëm.
- Të vlerësojë ofertën kulturore si pjesë e domosdoshme e potencialit primar turistik.
- Të dallojë rëndësinë e motiveve antropogjenë në ofertën turistike të një rajoni gjeografik.

- Të dallojë elementët e potencialit turistik sekondar dhe terciar.
- Të analizojë rolin e elementëve të potencialit turistik sekondar dhe terciar në zhvillimin e turizmit.
- Të analizojnë kushtet dhe faktorët kryesorë natyrorë, ekonomikë, kulturorë, infrastrukturor, për zona të caktuara me prioritet turistik, si bazë për lëvizjen turistike.
- Të përcaktojë kriteret e klasifikimit të formave dhe llojeve të ndryshme të lëvizjes turistike.
- Të argumentojë pasojat dhe efektet, që sjell zhvillimi i turizmit në një hapësirë të caktuar gjeografike.
- Të punojë me hartën turistike të botës.
- Të përcaktojë rolin e turizmit në zhvillimin ekonomik të Shqipërisë.
- Të vlerësojnë situatën e përgjithshme në Shqipëri e rajon, si dhe ndikimin që ka kjo situatë në zhvillimin e turizmit.
- Të analizojnë kushtet gjeografike – natyrore të Shqipërisë si: pozita gjeografike, relievi, klima, ujërat, bota bimore e shtazore me ndikimin e tyre në turizëm dhe në përcaktimin e llojeve të tij.
- Të analizojnë rajonet gjeografike të Shqipërisë, me potencialet natyrore që ato ofrojnë në zhvillimin e turizmit.
- Të evidentojnë problemet që lindin nga raportin mjedis gjeografik-turizëm nga zhvillimi i tij me ndikim reciprok.
- Të japin alternativa për mënyra të zgjidhjes së problemeve.
- Të analizojnë ofertën historiko-kulturore të Shqipërisë në turizëm.
- Të diskutojnë rreth historikut të zhvillimit të turizmit, sipas periudhave, duke evidentuar karakteristikat e secilës periudhë.
- Të analizojnë treguesit sasiorë të zhvillimit të turizmit, duke përcaktuar faktorët që ndikojnë në këta tregues.
- Të diskutojnë rreth politikës turistike dhe turizmit shqiptar.
- Të diskutojnë problemet që ka turizmi sot dhe për zhvillimin e tij në të ardhmen.
- Të interpretojnë harta turistike të Shqipërisë apo të zonave të veçanta të saj, me potencialin e tyre turistik.
- Të punojnë në mënyrë të pavarur, për të evidentuar efektet pozitive dhe negative të turizmit.

• **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Gjeografi turistike”, kl 13 – 64 orë**

<b>Tema 1</b>	Kuptimi gjeografik mbi turizmin.	3 orë
<b>Tema 2</b>	Elementët gjeografiko-natyrore dhe turizmi.	9 orë
<b>Tema 3</b>	Elementët gjeografiko-kulturore dhe turizmi	5 orë
<b>Tema 4</b>	Potenciali turistik sekondar dhe terciar, elementët e tij në studimin gjeografik të turizmit.	6 orë
<b>Tema 5</b>	Klasifikimi i llojeve, formave dhe vendeve turistike.	3 orë
<b>Tema 6</b>	Pasojat dhe efektet gjeografike të turizmit.	5 orë
<b>Tema 7</b>	Aspekte të zhvillimit të turizmit në rajon dhe në botë.	5 orë
<b>Tema 8</b>	Vendi dhe roli i turizmit në ekonominë shqiptare.	5 orë
<b>Tema 9</b>	Oferta gjeografiko-natyrore e Shqipërisë në fushën e turizmit.	5 orë
<b>Tema 10</b>	Oferta gjeografiko-kulturore e Shqipërisë në fushën e turizmit.	5 orë
<b>Tema 11</b>	Raportet midis ekonomisë, popullsisë dhe turizmit në Shqipëri.	6 orë
<b>Tema 11</b>	Pasojat dhe efektet gjeografike të turizmit për Shqipërinë.	3 orë
<b>Tema 12</b>	Problemet e sotme dhe e ardhmja e turizmit në Shqipëri.	4 orë

#### 4. Lënda “Ekonomi e turizmit” (L-13-297-20). Kl. 13 – 64 orë

##### • Synimet e lëndës “Ekonomi e turizmit”, kl. 13.

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Ekonomi e turizmit”, kl.13, nxënësit duhet:

- Të përshkruajnë konceptin e ekonomisë si shkencë shoqërore dhe sistemit ekonomik në tërësi.
- Të përshkruajnë veçoritë e tregut, elementët dhe mënyrat e funksionimit të tij..
- Të dallojnë veçoritë e strukturave të tregut, sipas karakteristikave të tyre.
- Të përshkruajnë kuptimin e industrisë së turizmit.
- Të dallojnë rëndësinë ekonomike të industrisë së turizmit dhe karakteristikat e saj.
- Të analizojnë tregun e produkteve turistike, duke identifikuar veçoritë dalluese të tij.
- Të analizojnë tregun turistik nga këndvështrimi i kërkesës turistike.
- Të analizojnë veçoritë e sjelljes konsumatore, si garanci për suksesin e aktivitetit të kompanisë.
- Të analizojnë tregun turistik, nga këndvështrimi i ofertës turistike.
- Të analizojnë faktorët e prodhimit (fuqia puntore, toka, kapitali) në turizëm.
- Të shpjegojnë konceptet kryesore të makroekonomisë.
- Të analizojnë ekuilibrin makroekonomik në turizëm dhe faktorët që ndihmojnë në arritjen e këtij ekuilibri.
- Të dallojnë funksionet ekonomike të turizmit, si: veçoritë e rritjes ekonomike, punësimin dhe papunësinë, inflacionin/deflacionin, bilancin e pagesave, inkurajimin e shkëmbimit ndërkombëtar, zhvillimin ekonomik të zonave të pazhvilluara, integrimin, etj, në aktualitetin e sotëm makroekonomik.
- Të përshkruajnë efektet e zhvillimit të turizmit në makroekonominë e një vendi.
- Të analizojnë shembuj konkrete të efekteve që ka zhvillimi i turizmit në makroekonominë e vendit tonë.
- Të identifikojnë politikat e zhvillimit të turizmit, duke analizuar mundësitë, faktorët dhe kushtet për zhvillimin e tij.
- Të tregojnë prioritetet, vizionin dhe objektivat kryesorë të strategjisë së turizmit.
- Të tregojnë modele të politikave monetare e fiskale që aplikohen në mbështetje të turizmit.
- Të përshkruajnë konceptin e zhvillimit të turizmit të qëndrueshëm, duke dhënë edhe shembuj të këtij modeli.
- Të dallojnë sfida në zbatimin e menaxhimit të qëndrueshmërisë dhe mbrojtjes së ekosistemit.
- Të identifikojnë modele, produkte dhe programe të reja, si dhe ato alternative që promovojnë një sistem turizmi të qëndrueshëm.
- Të përshkruajnë rolin e legjislacionit turistik në mbarëvajtjen e turizmit, si degë e ekonomisë.
- Të dallojë subjektet e të drejtës në turizëm.
- Të dallojë llojet e kontratave dhe marrëveshjeve ndërmjet subjekteve në turizëm.  
Të analizojnë të drejtat që ka konsumatori turist gjatë blerjes së produktit turistik, pasqyruar kjo në legjislacionin kombëtar dhe ndërkombëtar.

##### • Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Ekonomi e turizmit”, kl.13 - 64 orë

<b>Tema 1</b>	Ekonomia dhe sistemi ekonomik	<b>3 orë</b>
<b>Tema 2</b>	Tregu, struktura dhe elementët e tij	<b>6 orë</b>
<b>Tema 3</b>	Industria turistike dhe baza ekonomike e saj.	<b>6 orë</b>

<b>Tema 4</b>	Tregu turistik-kërkesa (sjellja konsumatore)	<b>8 orë</b>
<b>Tema 5</b>	Tregu turistik-oferta. Çmimi ekuilibër	<b>9 orë</b>
<b>Tema 6</b>	Treguesit dhe efektet makroekonomike të zhvillimit të turizmit.	<b>8 orë</b>
<b>Tema 7</b>	Politikat e zhvillimit të turizmit	<b>6 orë</b>
<b>Tema 8</b>	Modeli i zhvillimit të turizmit të qëndrueshëm	<b>8 orë</b>
<b>Tema 9</b>	E drejta në turizëm dhe legjislacionit turistik.	<b>6 orë</b>
<b>Tema 10</b>	Mbrojtja e konsumatorit turist dhe legjislacioni kombëtar dhe ndërkombëtar në mbrojtje të tij	<b>4 orë</b>

## 5. Lënda “Kontabilitet” (L-17-298-20). Kl. 13 – 64 orë

### • Synimet e lëndës “Kontabilitet”, kl. 13.

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Kontabilitet”, kl.13, nxënësit duhet:

- Të përshkruajnë detyrat, qëllimet, rolin dhe rëndësinë e kontabilitetit për strukturat hoteliere dhe turistike
- Të tregojnë ligjet kryesore që ekzistojnë në Shqipëri për kontabilitetin, qëllimin e hartimit dhe mënyrën e zbatimit të tyre.
- Të shpjegojnë objektivat kryesore për ndërtimin e pasqyrave financiare vjetore (bilanci, pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve).
- Të shpjegojnë kuptimin, përmbajtjen, llojet dhe qëllimin e mbajtjes së llogarive, si dhe t’i dallojnë ato.
- Të evidentojnë dallimet ndërmjet pasurisë dhe kapitalit, aktiveve dhe pasiveve.
- Të identifikojnë të drejtat dhe detyrimet e konstatuara të periudhës.
- Të ndërtojnë strukturën bazë të një bilanci të thjeshtë kontabël.
- Të përshkruajnë konceptet e të ardhurave dhe shpenzimeve, ndikimin që ato kanë në kapitalin e ndërmarrjes.
- Të përshkruajnë funksionimin e llogarive të të ardhurave dhe shpenzimeve.
- Të dallojnë llojet e të ardhurave dhe shpenzimeve në strukturat hoteliere dhe turistike.
- Të përshkruajnë strukturën e klasifikimit të kostove në fikse dhe variabël në strukturat hoteliere dhe turistike.
- Të identifikojnë rastet tipike tregtare gjatë ushtrimit të veprimtarisë në strukturat hoteliere dhe turistike.
- Të dallojnë llojet e kostove në strukturat hoteliere dhe turistike.
- Të identifikojnë procedurat e llogaritjes së kostove në strukturat hoteliere dhe turistike.
- Të kryejnë llogaritjen e kostove në strukturat hoteliere dhe turistike.
- Të dallojnë pjesët përbërëse të kalkulimit të çmimit të një produkti për shitje.
- Të llogarisin çmimin e produktit për shitje.
- Të përshkruajnë strukturën e klasifikimit të kostove në fikse dhe variabël në strukturat hoteliere dhe turistike, marzhin dhe tatimin për produktet për shitje.
- Të dallojnë ngjarjet ekonomike që ndodhin në një biznes.
- Të përshkruajnë efektet e veprimeve ekonomike në biznes dhe bilanc.
- Të kryejnë regjistrime praktike të dokumenteve në kontabilitet.
- Të kryejnë regjistrime të faturave, arkëtimeve, llogarive të arkëtueshme dhe të pagueshme gjatë periudhës.
- Të përshkruajnë llojet e taksave dhe tatimeve që aplikohen sipas llojeve dhe formave të ndërmarrjeve turistike.
- Të kryejnë veprimet e plotësimit të deklaratave tatimore në fund të periudhës ushtimore, sipas formës së ndërmarrjeve turistike.

- Të kryejnë veprimet e rregullimeve të marrëdhënieve me shtetin.
- Të kryejnë veprimet e mbylljes vjetore të një strukture hoteliere dhe turistike.
- Të ndërtojë bilancin dhe pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve në fund të veprimtarisë ushtrimore.
- Të analizojë rezultatet e pasqyrave financiare (bilanci, pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve), si matës të suksesit të kompanisë;
- Të kryejnë llogaritjen e treguesve ekonomikë bazë dhe vlerësimin kritik të tyre.
- Të analizojnë mbylljen vjetore si burim informacioni.

• **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Kontabilitet”, kl.13 - 64 orë**

<b>Tema 1</b>	Kontabiliteti dhe rëndësia e informacionit kontabël	4 orë
<b>Tema 2</b>	Llogaria, kuptimi, klasifikimi dhe dokumentacioni bazë.	8 orë
<b>Tema 3</b>	Struktura e të ardhurave dhe shpenzimeve	6 orë
<b>Tema 4</b>	Llogaritja e kostove dhe çmimit në strukturat hoteliere dhe turistike	12 orë
<b>Tema 5</b>	Regjistrime të thjeshta të veprimtarive në strukturat akomoduese, bizneset e ushqimit e pijeve dhe ato turistike.	16 orë
<b>Tema 6</b>	Tatimet dhe taksat. Rregullimi i marrëdhënieve me shtetin.	4 orë
<b>Tema 7</b>	Veprimet e mbylljes dhe ndërtimi i pasqyrave financiare	10 orë
<b>Tema 8</b>	Vlerësimi i mbylljes vjetore	4 orë

## IX. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale të detyruar

### 1. Moduli: “Krijimi dhe organizimi i strukturës hoteliere dhe turistike”

Drejtimi: Hoteleri-turizëm  
Niveli: IV i KSHK  
Klasa: 13

<i>PERSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodit	KRIJIMI DHE ORGANIZIMI I STRUKTURËS HOTELIERE DHE TURISTIKE	M-13-855-20
Qëllimi i modulit	Një modul që i pajis nxënësit me aftësi për të kryer veprimet dhe hartuar dokumentet e krijimit të strukturës hoteliere dhe turistike, përcaktuar formën juridike të saj dhe për të kryer veprimtaritë e punës sipas sektorëve.	
Kohëzgjatja e modulit	33 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për praninë	Nxënësit duhet të kenë përfunduar një nga profilet mësimore të nivelit të III të KSHK, të drejtimit mësimor Hoteleri-turizëm.	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	<b>RM 1 Nxënësi kryen studimin fillestar për krijimin e strukturës hoteliere dhe turistike dhe për hartimin e planit fillestar të biznesit.</b> <b>Kriteret e vlerësimit:</b> Nxënësi duhet të jetë i aftë: <ul style="list-style-type: none"><li>- të përshkruajë ciklin jetësor të FU (strukturë hoteliere dhe turistike);</li><li>- të kryejë studimin e kërkesës dhe ofertës në tregun e strukturave hoteliere dhe turistike që do të ofrojë në të;</li><li>- të përcaktojë qartë llojet e produkteve që do të tregtohen (strehim/akomodim, ushqim, pije, produkte turistike);</li><li>- të përcaktojë saktë shërbimet e tjera që do të ofrohen nga struktura hoteliere dhe turistike;</li><li>- të kryejë saktë studimin e tregut të ofruesve të produkteve dhe shërbimeve;</li><li>- të krahasojë ofertat, çmimet kushtet e ofruesve të shërbimeve duke evidentuar ofruesit potencialë të tyre;</li><li>- të përcaktojë saktë vendin e strukturës hoteliere dhe turistike në rrjetin e shpërndarjes së produkteve dhe shërbimeve;</li><li>- të përcaktojë qartë dhe në mënyrë të hollësishme, për muajt e parë, vëllimin e shitjeve në sasi dhe vlerë;</li><li>- të llogarisë saktë koston e parashikuar për njësi të produktit ose shërbimit objekt të veprimtarisë;</li><li>- të llogarisë saktë kosto të tjera të parashikuara variabël dhe</li></ul>	

- 
- fikse për ushtrimin e veprimtarisë;
  - të pasqyrojë saktë shpenzimet e parashikuara për reklamën dhe marketimin e produkteve dhe shërbimeve;
  - të hartojë pasqyra të sakta dhe të qarta të parashikimit të rezultatit;
  - të hartojë planin e biznesit duke përmbledhur në të të gjitha parashikimet e kryera;
  - të përcaktojë saktë strukturën e pasurisë së nevojshme për zhvillimin e veprimtarisë,
  - të përcaktojë saktë nevojën për kapitale të biznesit që do të krijohet.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

**RM 2 Nxënësi përcakton emrin dhe harton dokumentet bazë, në varësi të formës juridike të strukturës hoteliere dhe turistike.**

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përcaktojë emrin e kompanisë në varësi të veprimtarisë dhe imazhit që kërkon të përcjellë tek të tretët.
- të përzgjedhë formën juridike më të përshtatshme për ndërmarrjen, sipas mundësive të financimit dhe kërkesave të pronarëve;
- të hartojë dokumentacionin për krijimin e strukturës hoteliere dhe turistike, sipas formës së saj juridike, duke shfrytëzuar burimet e duhura;
- të hartojë një statut dhe një akt të thjeshtë të themelimit të strukturës hoteliere dhe turistike;
- të përcaktojë mënyrën për derdhjen e kapitalit fillestar;
- të dokumentojë saktë procedurat e caktimit të administratorëve në rastin e krijimit të shoqërisë;
- të përcaktojë saktë dhe qartë mënyrën se si do të bëhet derdhja e kapitalit fillestar të strukturës hoteliere dhe turistike.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

**RM 3 Nxënësi aplikon për licensim dhe regjistrim në organet përkatëse.**

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të identifikojë informacionin në faqen zyrtare të QKB mbi procedurën dhe dokumentat e licencimit;
- të plotësojë saktë formularët e aplikimit për licensim dhe të gjithë dokumentet që duhet të shoqërojnë aplikimin;
- të liçensohet pranë organeve përkatëse (QKB dhe/ose Ministria e Turizmit dhe Mjedisit), duke ndjekur afatet e liçencimit;
- të marrë në dorëzim certifikatat e liçensimit.



- të paraqitet në afatin e caktuar në zyrat e shërbimeve të tatimpaguesve për terheqjen e kodit të aksesit në faqen e tatimeve të biznesit;
- të plotësojë saktë dokumentacionin e kërkuar nga organet tatimore lokale;
- të paraqesë në afat dokumentacionin në organet tatimore lokale, shlyejë detyrimet duke institucionalizuar marrëdhëniet me to;
- të plotësojë saktë dhe paraqesë në kohë dokumentat për regjistrim në zyrat e inspektoriatit të punës;
- të deklarojë saktë online personelin e punësuar rishtazi, në momentin e çeljes së veprimtarisë së biznesit.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

**RM 4 Nxënësi kryen veprimtaritë e punës sipas sektorëve të strukturës hoteliere dhe turistike (FU).**

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të kryejë organizimin e dokumentacionit dhe veprimtarive dhe në Sektorin e Administratës;
- të kryejë organizimin e dokumentacionit dhe veprimtarive dhe në Sektorin e Sekretarisë;
- të kryejë organizimin e dokumentacionit dhe veprimtarive dhe në Sektorin e Shitjes;
- të kryejë organizimin e dokumentacionit dhe veprimtarive dhe në Sektorin e Blerjes;
- të kryejë organizimin e dokumentacionit dhe veprimtarive dhe në Sektorin e Kontabilitetit;
- të kryejë organizimin e dokumentacionit dhe veprimtarive dhe në Sektorin e Marketingut;
- të kryejë organizimin e dokumentacionit dhe veprimtarive dhe në Sektorin e Magazinës;
- të kryejë organizimin e dokumentacionit dhe veprimtarive dhe në Sektorin e Personelit (burimeve njerëzore);
- të kryejë plotësimin, përpunimin, administrimin dhe arkivimin e dokumenteve për punën e sektorëve;
- të përdorë programet kompjuterike të nevojshme për kryerjen e veprimtarive të FU;
- të përdorë Internetin, postën elektronike, komunikimet dhe veprimet on-line për kryerjen e veprimtarive të FU;
- të kryejë veprimtaritë administrative dhe financiare sipas sektorëve të FU;
- të komunikojë me korrektesë dhe me etikë profesionale

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

---

**Udhëzime për zbatimin e modulit**

- Ky modul duhet të trajtohet kryesisht në mjediset e firmës ushtrimore (FU).



---

**dhe për vlerësimin e nxënësve.**

- Moduli përbëhet nga shumë RM dhe trajtimi i tij duhet të shtrihet gjatë gjithë vitit shkollor. Ai duhet të zhvillohet paralelisht me module të tjerë.
- Për realizimin e modulit dhe RM-ve të tij nxënësit punojnë me grupe dhe qarkullojnë sipas një plani rotacioni të hartuar nga mësuesi.
- Ashtu si dhe në ndërmarrje të njëjta veprime përsëriten disa herë, dhe secili prej tyre performohet nga grupe të ndryshme nxënësish.
- Mësuesi i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur ilustrime dhe demonstrime konkrete të proceseve për studimin fillestar për krijimin e ndërmarrjes, për përcaktimin e formës juridike dhe dokumentacionit bazë të saj, për kryerjen e veprimtarive sipas sektorëve në strukturën hoteliere dhe turistike.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për studimin fillestar për krijimin e ndërmarrjes, për përcaktimin e formës juridike dhe dokumentacionit bazë të saj, për kryerjen e veprimtarive sipas sektorëve në strukturën hoteliere dhe turistike.
- Mësuesi i praktikës duhet të mbikqyrë respektimin e rregullave të sigurimit teknik, të mbrojtjes së mjedisit dhe mirëmbajtjes së mjeteve dhe pajisjeve të punës.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike, për studimin fillestar për krijimin e ndërmarrjes, për përcaktimin e formës juridike dhe dokumentacionit bazë të saj, për identifikimin e nevojave për personel, si dhe rekrutimin e punësimit të tij.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike, për realizimin e procedurave për krijimin dhe organizimin e strukturës hoteliere dhe turistike.

---

**Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit**

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:
- mjedis i firmës ushtrimore;
  - mjetet dhe pajisjet e punës, për krijimin e organizimin e nd/jes;
  - mjete kancelarie, kompjuter ne lidhje me internetin.
  - modele statutesh, aktesh themelimi, planesh biznesi, dosjesh aplikimi në QKB të marra nga ndërmarrje konkrete, për krijimin dhe organizimin e ndërmarrjes;
  - formularë aplikimi dhe regjistrimi në QKB;
  - pasqyra, deklaratat të parashikimit të fitimit etj.
-

## 2. Moduli: “Veprime të blerjes dhe të shitjes në treg.”

**Drejtimi:** Hoteleri-turizëm  
**Niveli:** IV i KSHK  
**Klasa:** 13

### PERSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	VEPRIME TË BLERJES DHE TË SHITJES NË TREG	M-17-1656-20
<b>Qëllimi i modulit</b>	Një modul, që i pajis nxënësit me aftësi praktike për të kryer procedurën e blerjes dhe të shitjes, në kushtet e një tregu edhe ndërkombëtar dhe konkurrues, si dhe për të dokumentuar dhe regjistruar blerjet dhe shitjet.	
<b>Kohëzgjatja e modulit</b>	33 orë mësimore	
<b>Niveli i parapëlqyer për pranim</b>	Nxënësit duhet të kenë përfunduar një nga profilet mësimore të nivelit të III të KSHK, të drejtimit mësimor Hoteleri-turizëm.	
<b>Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit</b>	<p><b>RM 1 Nxënësi analizon furnitorët potencialë në fushën e biznesit.</b> <i>Kriteret e vlerësimit:</i> Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>- të kërkojë me kujdes dhe të orientuar nga qëllimi, informacione për furnitorë vendas dhe për furnitorë në tregun ndërkombëtar;</li><li>- të identifikojë furnitorët potencialë, me të njëjtin objekt veprimtarie me ndërmarrjen tonë;</li><li>- të hartojë lista përmbledhëse me informacione të qarta dhe të plota të furnitorëve potencialë të identifikuar;</li><li>- të shqyrtojë kartelat e furnitorëve potencialë, për periudhat e kaluara, duke identifikuar qartë furnitorët aktualë;</li><li>- të hartojë statistika të sakta dhe të plota përmbledhëse me informacione për furnitorët aktuale, mbi bazën e veprimeve dhe vëllimit të shitjeve të realizuar me ta.</li></ul> <p><i>Instrumentet e vlerësimit:</i></p> <ul style="list-style-type: none"><li>- Vëzhgim me listë kontrolli.</li></ul> <p><b>RM 2 Nxënësi vendos marrëdhënie me furnitorët aktualë.</b> <i>Kriteret e vlerësimit:</i> Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>- të identifikojë saktë blerjet, të cilat do të kryhen pranë furnitorëve (firmave);</li><li>- të vendosë marrëdhënie korrekte me furnitorët duke i dokumentuar ato;</li><li>- të kërkojë oferta nga furnitorët me lista çmimesh për produkte;</li><li>- të përgatisë porositë përkatëse për produktet që do të</li></ul>	

- blihen, në bazë të nevojave për blerje;
- të llogarisë sipas llojeve, sasi të e produkteve që do të blihen pranë furnitorëve.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

**RM 3 Nxënësi kryen blerjet dhe regjistrimin e tyre për biznesin dhe personelin.**

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të marrë ofertat nga ofruesit e produkteve/shërbimeve;
- të regjistrojë ofertat e marra nga ofruesit e produkteve/shërbimeve;
- të krahasojë ofertat e mbërritura nga furnitorë të ndryshëm, në bazë të kushteve dhe veçorive të tyre;
- të llogarisë ofertat, duke përcaktuar ofertën më të mirë;
- të hartojë kontratat të sakta me ofruesit e përzgjedhur si oferta më e mirë (përshtatshme);
- të kryejë porositë në ofruesit e përzgjedhur për tregun;
- të plotësojë saktë formularët për secilin ofrues;
- të regjistrojë me saktësi porositë;
- të kryejë saktë regjistrimet e blerjeve në kartelat e furnitorëve;
- të regjistrojë blerjet për veprimtarinë e biznesit në kartelat e magazinës;

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

**RM 4 Nxënësi analizon klientët potencialë dhe aktualë në fushën e biznesit.**

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të kërkojë me kujdes në mënyrë të orientuar nga qëllimi informacione për klientë shoqëri apo individë, vendas dhe të huaj;
- të shfrytëzojë burime dhe mjete të ndryshme të duhura të informacionit, për gjetjen e klientëve potencialë;
- të hartojë lista të qarta dhe të plota të klientëve potencialë të identifikuar nga kërkimi, veçorive dhe kërkesave të tyre, si dhe kontakteve me to;
- të shqyrtojë kartelat e klientëve ekzistues, të periudhave të kaluara;
- të hartojë statistika të sakta të shitjeve të periudhave të kaluara të analizuara, sipas klientëve;
- të hartojë lista të klientëve në të cilat të pasqyrojë saktë preferencat dhe kërkesat e vecanta të secilit prej tyre si dhe kushtet e lëvrimit dhe të pagesave të deritanishme me ta;
- të përcaktojë saktë klientët e preferuar dhe format e trajtimit të veçantë të tyre, duke evidentuar dhe kërkesat e

- tyre në të ardhmen.
- të shqyrtojë kartelat e klientëve aktualë, për periudhat e kaluara;
- të hartojë statistika të sakta dhe të plota përmbledhëse me informacione për klientët aktualë, mbi bazën e veprimeve dhe vëllimit të shitjeve të realizuar me ta.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

**RM 5 Nxënësi nxit dhe vendos marrëdhënie me klientët.**

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë, në bashkëpunim me sektorin e marketingut materialet informative që u dërgohen klientëve;
- të reklamojë, nëpërmjet internetit, materialet informative të ndërmarrjes për vendosjen e marrëdhënieve të biznesit me klientët;
- të përpunojë saktë informacionet e marra nga klientët e kontaktuar, që kanë shfaqur interes;
- të hartojë lista të plota të klientëve me të cilët parashikohet të vazhdohen marrëdhëniet e biznesit;
- të dërgojë informacione të plota klientëve mbi listën e çmimeve dhe katalogëve;
- të dërgojë oferta të veçanta, për ulje çmimi, kushte të veçanta lëvrimi e pagese, dhurata, etj.;
- të dërgojë anketime për kërkesa të veçanta të klientëve;
- të hartojë planin e detajuar të përmbushjes së kërkesave të klientëve.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

**RM 6 Nxënësi kryen shitjet dhe regjistrimet përkatëse.**

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të hartojë kontratat e shitblerjes, mbi bazë e elementëve ligjorë;
- të përpunojë kërkesat e klientëve;
- të regjistrojë saktë porositë e mbërritura nga klientët;
- të kontrollojë gjendjen e produkteve sipas cilësisë dhe sasisë së tyre;
- të dërgojë njoftimet sektorit të blerjeve, për plotësimin e gjendjes së produkteve, në rast se ato nuk disponohen;
- të hartojë saktë dëftesat e lëvrimin dhe fletëdaljet e produkteve për t'u shitur;
- të hartojë saktë faturat e shitjes së produkteve;
- të regjistrojë, saktë, ekzekutimin e porosive të klientëve;
- të plotësojë kartelat individuale të klientëve;
- të regjistrojë saktë pakësimin e gjendjes së mallrave të shitura në kartelat e magazinës;
- të dërgojë, brenda afateve, në zyrën e kontabilitetit

dokumentet e shitjes për ndjekjen e arkëtimeve.

**Instrumentet e vlerësimit:**

- Vëzhgim me listë kontrolli.

**RM 7 Nxënësi kryen blerje dhe shitje për biznesin dhe personelin në Web-shop.**

**Kriteret e vlerësimit:**

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të kërkojë informacion për firmat në Web-shop, për nevojat për blerje të strukturës hoteliere dhe turistike, të orientuara sipas produkteve të kërkuara për blerje;
- të identifikojë saktë produktet që do të porositen,
- të krahasojë ofertat dhe kushtet e lëvrimin e të pagesës së tyre;
- të përzgjedhë saktë ofertën më të mirë;
- të kryejë saktë porosinë për produktet që do të blihen;
- të kryejë ruajtjen elektronike dhe printimin e porosisë së kryer;
- të regjistrojë saktë porosinë në regjistrin e porosive të kryera;
- të përcjellë në kohë porosinë për blerje, për përdorime të mëtejshme, duke zbatuar të njëjtën procedurë me atë të blerjeve të tjera.
- të kontrollojë rubrikën e porosive në faqen e Web-shop, duke identifikuar saktë porositë e reja që duhet të përpunohen;
- të përpunojë dhe të regjistrojë saktë porositë e reja në regjistrin e tyre, duke ndjekur të njëjtën procedurë me atë të shitjeve në forma të tjera;
- të dërgojë në formë elektronike konfirmimin për marrjen e porosisë;
- të ruajë porosinë në formën e përshtatshme elektronike, për ta përdorur për qëllime të mëtejshme.

**Instrumentet e vlerësimit:**

- Vëzhgim me listë kontrolli.

---

**Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve.**

- Ky modul duhet të trajtohet në mjediset e firmave ushtrimore.
- Mësuesi i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet e dokumenteve dhe formularëve të marrë nga praktika e ndërmarrjeve ekonomike.
- Mësuesi i praktikës duhet të mbikëqyrë respektimin e rregullave të mbrojtjes së mjedisit dhe mirëmbajtjes së mjeteve dhe pajisjeve të firmës ushtrimore.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për të kërkuar informacione në treg, krahasuar oferta, kryer dhe regjistruar porosi, kryer blerjet, dokumentimin dhe regjistrimet përkatëse të tyre, për analizimin e klientëve potencialë, nxitjen e marrëdhënieve me ta, sigurimin e klientëve të rinj, hartimin e kontratave të shitblerjes, kryerjen e shitjeve të drejtpërdrejta dhe në Web-shop, si dhe dokumentimin e regjistrimin e këtyre

---

shitjeve.

- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e proceseve të punës për të kërkuar informacione në treg, krahasuar oferta, kryer dhe regjistruar porosi, kryer blerjet, dokumentimin dhe regjistrimet përkatëse të tyre, analizimin e klientëve potencialë, nxitjen e marrëdhënieve me ta, hartimin e kontratave të shitblerjes, kryerjen e shitjeve të drejtpërdrejta dhe në Web-shop, si dhe dokumentimin e regjistrimin e këtyre shitjeve.

---

**Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit**

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:

- mjediset e firmave ushtrimore,
  - materiale kancelarie,
  - dokumente të ndryshme korrespondence model nga ndërmarrjet reale dhe të përgatitura nga mësuesi,
  - dëftesa lëvrimi, formularë, fatura, regjistra të blerjeve të marra nga praktika ose përpunuar në modulet e mëparshme,
  - kompjuter i lidhur me internetin,
-

### 3. Moduli: “Oferta e produkteve dhe shërbimeve në strukturën hoteliere dhe turistike”

Drejtimi: Hoteleri-turizëm  
Niveli: IV i KSHK  
Klasa: 13

#### PERSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe Kodi	<b>PËRGATITJA E OFERTËS SË PRODUKTEVE DHE SHËRBIMEVE NË STRUKTURËN HOTELIERE DHE TURISTIKE</b>	<b>M-13-1657-20</b>
Qëllimi i modulit	Një modul që aftëson nxënësit për të analizuar kërkesat në lidhje me produktet dhe shërbimet në strukturën hoteliere dhe turistike, për të krijuar produktin/shërbimin, për të llogaritur kostot dhe për të vendosur marrëdhënie me furnitorët.	
Kohëzgjatja e modulit	33 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar një nga profilet mësimore të nivelit të III të KSHK, të drejtimit mësimor Hoteleri-turizëm.	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	<b>RM 1 Nxënësi analizon kërkesën për produkte dhe shërbime në strukturën hoteliere dhe turistike.</b> <b>Kriteret e vlerësimit:</b> Nxënësi duhet të jetë i aftë: <ul style="list-style-type: none"><li>- të dallojë mënyrat e analizës dhe specifikimit të kërkesave për produkte dhe shërbime në strukturën hoteliere dhe turistike;</li><li>- të analizojë elementët e kërkesës për produkte dhe shërbime në strukturën hoteliere dhe turistike;</li><li>- të përdorë informacionet e studimit të tregut në funksion të evidentimit të produkteve dhe shërbimeve të kërkuara dhe objektivave të strukturës hoteliere dhe turistike;</li><li>- të përcaktojë me objektivitet produktet dhe shërbimet e kërkuara nga tregu në hoteleri - turizëm;</li><li>- të analizojë mundësitë që ka biznesi për të ofruar produktet dhe shërbimet e kërkuara nga tregu;</li><li>- të vlerësojë efektivitetin e produkteve dhe shërbimeve të kërkuara;</li><li>- të marrë vendim lidhur me produktet dhe shërbimet që do të ofrohen, në përmbushje të kërkesave të tregut.</li><li>- të përshtasë produkte dhe shërbime për klientë me buxhete të ndryshme financiare;</li><li>- të përzgjedhë furnitorët sipas llojeve të produkteve dhe shërbimeve që do të ofrohen;</li><li>- të demonstrojë përgjegjshmëri, këmbëngulje, inovacion, inisiativë, aftësi për të punuar brenda afateve në mënyrë të pavarur dhe në grup.</li></ul>	

---

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

**RM 2 Nxënësi krijon produkte dhe shërbime në strukturën hoteliere dhe turistike.**

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të analizojë kërkesat e klientëve për produkte apo shërbime në ndërmarrje sipas llojit dhe sipas procedurës;
- të analizojë çmimin e kërkuar nga klienti;
- të specifikojë të dhënat për produktet e shërbimet e ofruara;
- të evidentojë në mënyrë të detajuar veprimtaritë që do të kryhen në rrjedhë kohore për realizimin e produkteve dhe shërbimeve;
- të përshkruajë saktë produktet dhe shërbimet që do të ofrohen;
- të krijojë produktin, shërbimin sipas kërkesave të klientëve të tregut të synuar nga struktura hoteliere dhe turistike;
- të llogarisë koston e produkteve dhe shërbimeve bazuar në çmimet e kontraktuara me furnitorët;
- të llogarisë çmimin total të produkteve / shërbimeve;
- të krahasojë çmimin e llogaritur me çmimin e tregut dhe llogarisë diferencat;
- të përshtasë çmimin e produkteve/shërbimeve me atë të tregut;
- të llogarisë çmimin përfundimtar të katalogut;
- të përcaktojë saktë rabatet dhe skontot që do të ofrohen mbi çmimin;
- të përshkruajë produktet dhe shërbimet në katalog dhe t'i përkthejë në gjuhë të huaj;
- të hartojë një plan të detajuar dhe të plotë të marketingut të produkteve dhe shërbimeve;
- të llogarisë saktë kostot për marketing;
- të publikojë produktet dhe shërbimet në faqen e internetit, rrjetet sociale etj;
- të demostrojë përgjegjshmëri, këmbëngulje, inovacion, iniciativë, aftësi për të punuar brenda afateve në mënyrë të pavarur dhe në grup.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

**RM 3 Nxënësi vendos marrëdhënie me furnitorët e produkteve dhe shërbimeve.**

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përdorë rezultatet e studimit të tregut të blerjes për të evidentuar furnitorët potencialë të produkteve/ shërbimeve të nevojshme;



- të vendosë marrëdhënie me furnitorët sipas llojeve të produkteve dhe shërbimeve që nevojiten;
- të kontaktojë në kohë furnitorët e produkteve/ shërbimeve për të konfirmuar disponibilitetin e tyre;
- të negociojë me furnitorët çmimet e produkteve/shërbimeve;
- të testojë produktin/shërbimin nga stafi i departamentit përkatës në strukturën hoteliere dhe turistike;
- të testojë produktin/ shërbimin nga operatorët blerës të produktit;
- të hartojë kontrata të shërbimeve me furnitorët në bazë të datave, sasive dhe kushteve të negociuara duke respektuar normativat ligjore në fuqi;
- të demonstrojë përgjegjshmëri, këmbëngulje, inovacion, iniciativë, aftësi për të punuar brenda afateve në mënyrë të pavarur dhe në grup.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

---

**Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve.**

- Ky modul duhet të trajtohet në mjediset e firmave ushtrimore.
- Për realizimin e modulit dhe RM-ve të tij nxënësit punojnë me grupe dhe qarkullojnë sipas një plani rotacioni të hartuar nga mësuesi.
- Mësuesi i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur ilustrime dhe demonstrime konkrete të veprimtarive që lidhen me çështjet e trajtuara.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për të përpunuar të dhënat, për të krijuar produktin/shërbimin, për të llogaritur kostot, çmimet, promovuar produktet/ shërbimet dhe për të vendosur marrëdhënie me furnitorët.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

---

**Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit**

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:

- Mjediset e firmave ushtrimore;
  - Kompjuter.
  - Internet.
  - Materiale kancelarie.
  - Modele kërkesash dhe ofertash;
  - Broshura dhe materiale të ndryshme promovionale të produkteve dhe shërbimeve të cilat mund të përdoren për ilustrim dhe shëmbuj.
-

#### 4. Moduli: “Menaxhimi i personelit në strukturën hoteliere dhe turistike”

Drejtimi: Hoteleri-Turizëm  
Niveli: IV i KSHK  
Klasa: 13

<i>PERSHKRUESI I MODULIT</i>		
<b>Titulli dhe Kodi</b>	<b>MENAXHIMI I PERSONELIT NË STRUKTURËN HOTELIERE DHE TURISTIKE</b>	<b>M-13-1658-20</b>
<b>Qëllimi i modulit</b>	Një modul praktik, që i pajis nxënësit me aftësi praktike për të kryer procedurat e punësimit të personelit, dokumentuar veprimet e kryera dhe kryer regjistrimet e duhura në strukturën hoteliere dhe turistike.	
<b>Kohëzgjatja e modulit</b>	30 orë mësimore	
<b>Niveli i parapëlqyer për pranim</b>	Nxënësit duhet të kenë përfunduar një nga profilet mësimore të nivelit të III të KSHK, të drejtimit mësimor Hoteleri-turizëm.	
<b>Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit</b>	<p><b>RM 1 Nxënësi identifikon dhe planifikon nevojat për personel.</b> <i>Kriteret e vlerësimit:</i> Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>- të mbledhë informacion të saktë dhe të plotë nga sektorët e strukturës hoteliere dhe turistike për nevojat për personel;</li><li>- të analizojë saktë dhe me përgjegjshmëri kërkesat e sektorëve për personel;</li><li>- të përcaktojë saktë nevojat për personel të ri, sipas sektorëve të strukturës hoteliere dhe turistike;</li><li>- të hartojë formularët përmbledhës për personelin e ri;</li><li>- të marrë vendimin përfundimtar për personel të ri, sipas analizës së nevojave.</li><li>- të përcaktojë dokumentet dhe kriteret e nevojshme për vendet e lira të punës, sipas standardeve të kërkuara (Kërkesë punësimi, CV, dokumente vërtetuese të aftësive profesionale dhe personale të kandidatit);</li><li>- të reklamojë, sipas standardeve, vendet e lira të punës në media.</li></ul> <p><i>Instrumentet e vlerësimit:</i></p> <ul style="list-style-type: none"><li>- Vëzhgim me listë kontrolli.</li></ul> <p><b>RM 2 Nxënësi harton njoftimet për vendet e reja të punës.</b> <i>Kriteret e vlerësimit:</i> Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>- të formulojë një njoftim të qartë për personelin që kërkohet;</li><li>- të renditë sipas rëndësisë listën e saktë të dokumenteve që do t'u kërkohen kandidatëve.</li><li>- të përcaktojë mjetet/mënyrat me të cilat mund të kryhet</li></ul>	

- njoftimi për vende të reja pune ose rikualifikim
- të llogarisë me saktësi kostot paraprake të njoftimeve;
- të marrë një vendim të argumentuar ekonomikisht dhe efektiv për mënyrën e publikimit të njoftimit;
- të publikojë njoftimin sipas mënyrës së përzgjedhur.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

**RM 3 Nxënësi kryen procedurat e rekrutimit të personelit.**

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të shqyrtojë me korrektësi dokumentat e kandidatëve për vendet e punës;
- të hartojë kriteret profesionale dhe korrekte për vlerësimin e kandidatëve;
- të formulojë saktë pyetësorët dhe formularët për kandidatët që intervistohen;
- të realizojë me korrektësi dhe profesionalizëm intervistat me kandidatët e përzgjedhur nga seleksionimi i dosjeve;
- të kryejë vlerësim objektiv bazuar në dokumentacionin dhe rezultatin e intervistës;
- të marrë vendimin e duhur lidhur me pranimin e kandidatëve;
- të kryejë publikimin e emrave fitues dhe njoftimin e sektorëve për personelin e ri.
- Të prezantojë kandidatit fitues me vendin e punës.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

**RM 4 Nxënësi kryen procedurat e punësimit.**

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të jetë i aftë të përzgjedhë dhe të përdorë në mënyrë korrekte të gjithë informacionin mbi bazën ligjore që rregullon marrëdhëniet e punës.
  - të negociojë lidhur me kushtet e punës, pagesën etj
  - të hartojë kontratën e punës mbështetur në kuadrin ligjor, kodin e punës dhe negociatave paraprake.
  - të nënshkruaj kontratën e punës.
  - të regjistrojë me saktësi punonjës/in/it e ri/nj në regjistrin themeltar të njësisë ekonomike.
  - të kryejë regjistrimin në zyrën e punës, sigurimet shoqërore dhe të marrë numrin/at e sigurimeve.
  - të çelë librezat e punës dhe sigurimeve shoqërore.
- të kryejë regjistrimin e punonjësit/ve të ri/nj në librin e pagave

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

**RM 5 Nxënësi harton planin e veprimeve për zhvillimin e personelit dhe trajnimin e vazhdueshëm të tij.**

**Kriteret e vlerësimit:**

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të identifikojë nevojat për kualifikime sipas sektorëve dhe vendeve të punës;
- të ndërtojë një plan kualifikimi të personelit të ri;
- të hartojë një program rikualifikimi për personelin ekzistues;
- të llogarisë kostot për veprimtaritë kualifikuese dhe rikualifikuese.

**Instrumentet e vlerësimit:**

- Vëzhgim me listë kontrolli.

---

**Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve.**

- Ky modul mund të trajtohet në mjediset e firmës ushtrimore por gjithashtu edhe në mjediset e strukturave hoteliere dhe turistike, i shtrirë në kohë përgjatë një viti shkollor.
- Për realizimin e modulit dhe përmbushjen e RM-ve nxënësit ndahen në grupe, hartohet një plan qarkullimi nga mësuesi.
- Sikurse në njësitë e tjera ekonomike e njëjta veprimtari mund të realizohet më shumë sesa një herë kështu që u jepet mundësia nxënësve që të ndarë në grupe të performojnë në rolin e punonjësit të burimeve njerëzore.
- Mësuesi duhet të tregohet sa më fleksibël dhe të krijojë mundësinë që nxënësit të marrin vendime të pandikuara dhe të drejta.
- Nxënësi duhet të angazhohet konkretisht në planifikimin, përzgjedhjen, punësimin, kualifikimin, rikualifikimin dhe largimin nga puna të stafit të strukturës hoteliere dhe turistike.
- Nxënësi duhet të kryejë procedurat e punësimit dhe dokumentimit të personelit në strukturën hoteliere dhe turistike
- Vlerësimi i nxënësve të argumentohet dhe të bazohet në aftësitë dhe shprehjet praktike të fituara dhe të demonstruar në këto veprimtari.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqëshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të mësuarit.

---

**Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit**

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:

- mjedis i firmës ushtrimore;
  - materiale kancelarie;
  - dokumente të ndryshme model nga ndërmarrjet reale dhe të përgatitura nga mësuesi;
  - mjete kancelarie, kompjuter ne lidhje me internetin;
  - formularë, dëftesa lëvrimi, fatura, rregjistra të shitjeve të marra nga praktika ose përpunuar në modulet e mëparshme;
  - materiale të ndryshme informative të marra nga Qendra Shqiptare e Firmave Ushtrimore (ALCT), qendrat e tjera të FU-ve, panairët e FU-ve, seminare të ndryshme të organizuara.
-

## 5. Moduli: “Kontabilizime të thjeshta në strukturën hoteliere dhe turistike”

Drejtimi: Hoteleri-Turizëm  
Niveli: IV i KSHK  
Klasa: 13

<i>PERSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	KONTABILIZIME TË THJESHTA NË STRUKTURËN HOTELIERE DHE TURISTIKE	M-17-1659-20
Qëllimi i modulit	Një modul, që i pajis nxënësit me aftësi praktike për të realizuar kontabilizime të thjeshta në strukturën hoteliere dhe turistike (Ilogaritje ekonomike, kontabilizime dhe mbylljen vjetore, ndërtimin e pasqyrave financiare të veprimtarisë ekonomike në strukturat hoteliere dhe turistike).	
Kohëzgjatja e modulit	30 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar një nga profilet mësimore të nivelit të III të KSHK, të drejtimit mësimor Hoteleri-turizëm.	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	<p><b>RM 1 Nxënësi regjistron në kontabilitet veprimet për krijimin ose zgjerimin e strukturës hoteliere dhe turistike.</b> <b>Kriteret e vlerësimit:</b> Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>- të kryejë saktë regjistrimin kontabël të kapitalit fillestar të derdhur nga pronarët për krijimin/zgjerimin e strukturës hoteliere dhe turistike;</li><li>- të kryejë saktë regjistrimin kontabël të shumave të shpenzimeve të paguara paraprakisht për krijimin, regjistrimin, asistencën ligjore si dhe për zgjerimin e veprimtarisë, sipas formës juridike të strukturës hoteliere dhe turistike;</li><li>- të hartojë saktë në kompjuter regjistrat kontabël (ditarin, librin e madh, partitarët, ditarët analitikë) në formë modelesh, për veprimtarinë e strukturës hoteliere dhe turistike;</li><li>- të kryejë saktë regjistrimin kontabël të gjendjeve të bilancit fillestar (artikulli i çeljes) në ditar;</li><li>- të kryejë saktë çeljen e kartelave të magazinës, sipas formatit të përcaktuar.</li></ul> <p><b>Instrumentet e vlerësimit:</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>- Vëzhgim me listë kontrolli.</li></ul> <p><b>RM 2 Nxënësi regjistron në kontabilitet blerjet dhe shitjet e produkteve për strukturën hoteliere dhe turistike, si dhe pagesat dhe arkëtimet përkatëse.</b> <b>Kriteret e vlerësimit:</b></p>	

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të çelë ditarin analitik të blerjeve, duke respektuar normativat ligjore në fuqi;
- të regjistrojë saktë faturat e blerjes së produkteve në ditarin analitik të blerjeve;
- të kryejë regjistrimin e saktë kontabël në shtim të gjendjes së produkteve në magazinë;
- të kryejë regjistrimin e saktë të faturave të blerjeve në regjistrin e faturave të marra.
- të çelë ditarin analitik të shitjeve, duke respektuar normativat ligjore në fuqi;
- të regjistrojë saktë faturat e shitjeve të produkteve në ditarin analitik të shitjeve;
- të kryejë regjistrimin kontabël, në pakësim, të gjendjes së produkteve;
- të regjistrojë saktë faturat e shitjeve në regjistrin e faturave të emetuara.
- të kontabilizojë saktë arkëtimin e faturave të shitjes duke kryer dhe përditësimet përkatëse në regjistrin e faturave të emetuara;
- të hartojë saktë urdhrin e transfertës për pagesën e produkteve dhe shërbimeve të blera;
- të kontabilizojë saktë pagesën e produkteve apo shërbimeve të blera.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

### **RM 3 Nxënësi kryen vlerësime dhe kontabilizime përkatëse në magazinë.**

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të vlerësojë saktë koston e mallit të shitur (KMSH) sipas metodave të legjislacionit në fuqi.
- të kryejë saktë regjistrimin e KMSH në librat përkatës;
- të kontabilizojë saktë daljet e lëndëve të para dhe materialeve për prodhim;
- të kontabilizojë saktë hyrjen e produkteve nga repartet e prodhimit në magazinë;
- të vlerësojë saktë gjendjen përfundimtare të magazinës nëpërmjet inventarizimeve të sakta dhe të plota të saj;
- të kontabilizojë saktë gjendjet e magazinës dhe ndryshimin e tyre;
- të kontabilizojë saktë diferencat në magazinë;
- të kuadrojë magazinën me repartet e prodhimit për materialet, lëndët e para dhe produktet e gatshme.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

### **RM 4 Nxënësi kryen deklarimin dhe kontabilizimin e shpenzimeve dhe detyrimeve të punës, sigurimeve dhe**

## **TAP.**

### ***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të plotësojë online listëpagesat sipas afateve në varësi të llojit të biznesit;
- të deklarojë online detyrimet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat;
- të kryejë saktë rregjistrimin kontabël, duke u bazuar në listëpagesën e pagave shpenzimet e punës, detyrimet ndaj personelit, sigurimeve dhe shtetit për TAP;
- të kontabilizojë saktë, duke u bazuar në listëpagesat e sigurimeve, shpenzimet përkatëse që përballohen nga agjencia;
- të hartojë dhe dërgojë në bankë urdhër pagesën për pagesën e shpërblimeve të punës.
- të shkarkojë urdhër pagesën, për pagesën e detyrimeve të sigurimeve dhe TAP;
- të dërgojë në bankë urdhër pagesën, për pagesën e detyrimeve të sigurimeve dhe TAP;
- të kontabilizojë saktë pagesën e detyrimeve për shpërblimet e punës, sigurimet dhe TAP

### ***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

## **RM 5 Nxënësi kryen vlerësimin e aktiveve afatgjata.**

### ***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të kryejë saktë kontabilizimin e blerjes dhe hyrjes së aktiveve afatgjata, sipas prejardhjes;
- të llogarisë saktë, sipas normativave ligjore në fuqi, amortizimin e aktiveve afatgjata sipas llojeve dhe grupeve të tyre;
- të kryejë saktë rregjistrimin kontabël të shpenzimeve të amortizimit të aktiveve afatgjata;
- të kontabilizojë saktë daljen e aktiveve afatgjata për destinacione dhe qëllime të ndryshme (jashtë përdorimit, faljen, shitjen e tyre).

### ***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

## **RM 6 Nxënësi kontabilizon shpenzime, të ardhura, pagesa dhe arkëtime të tjera**

### ***Kriteret e vlerësimit:***

- të kontabilizojë saktë shpenzimin dhe pagesën për taksat lokale;
- të shkarkojë dhe dorëzojë urdhër pagesat për kuotat e parashikuara të tatimit mbi fitimin;
- të shkarkojë dhe dërgojë në bankë urdhër pagesat për pagesën e tatimit mbi fitimin në rastin e biznesit të vogël;
- të kontabilizojë saktë pagesat për tatimin mbi fitimin;

- të kontabilizojë saktë shpenzimet për blerjet e materialeve të zyrës dhe mirëmbajtjes dhe i pagesën e tyre
- të kontabilizojë saktë shpenzimet për shërbime të tjera të blera (energji, telefon, ujë, internet, etj) dhe pagesën e tyre.
- të kontabilizojë saktë shpenzimet/pagesat për interesa, qera, etj;
- të kontabilizojë saktë arkëtimet/të ardhurat nga interesa e qera.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

**RM 7 Nxënësi kryen veprimet e mbylljes dhe hartimit të bilancit përfundimtar.**

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të kryejë saktë kontabilizimin e përmbledhjes së shpenzimeve;
- të regjistrojë saktë në kontabilitet përmbledhjen e të ardhurave;
- të llogarisë saktë, rezultatit ekonomik të biznesit turistik;
- të hartojë saktë, dhe sipas normativave ligjore në fuqi bilancin e thjeshtë të veprimtarisë së biznesit turistik.
- të delarojë online në afat tatimin përfundimtar mbi fitimin;
- të delarojë online në afat pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve;
- të delarojë online në afat fitimin e parashikuar për vitin e ardhshëm;
- të kontabilizojë saktë tatimin e fitimit përfundimtar dhe pagesën e diferencave.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

**Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve.**

- Ky modul duhet të trajtohet në mjediset e firmave ushtrimore. Realizimi i RM 3 ka si veçori që duhet të trajtohet në atë mënyrë që i përshtatet veprimtarisë së FU. Në se është ndërmarrje prodhuese ka magazinë produktesh dhe lëndësh të para, në se është ndërmarrje tregtare ka magazinë mallrash. Gjithashtu RM-ja konsiderohet e arritur në se zgjidhet njëra prej metodave të vlerësimit LIFO ose FIFO si dhe njëra nga metodat e regjistrimit kontabël: inventarit periodik ose të përhershëm. Marrja e vendimit është pavarësi e mësuesit.
- Mësuesi i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet e dokumenteve dhe formularëve të marrë nga praktika e strukturave hoteliere dhe turistike.
- Mësuesi i praktikës duhet të mbikqyrë respektimin e rregullave të mbrojtjes së mjedisit dhe mirëmbajtjes së mjeteve dhe pajisjeve të firmës ushtrimore.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për të kryer llogaritje ekonomike, kontabilizime dhe mbylljen vjetore, për ndërtimin e pasqyrave financiare të veprimtarisë



---

ekonomike të strukturës hoteliere dhe turistike.

- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për të kryer llogaritje ekonomike, kontabilizime dhe mbylljen vjetore, për ndërtimin e pasqyrave financiare të veprimtarisë ekonomike të strukturës sonë hoteliere dhe turistike.

---

**Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit**

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:

- mjedis i firmës ushtrimore;
  - materiale kancelarie;
  - dokumente të ndryshme financiare, model nga strukturat reale hoteliere e turistike dhe të përgatitura nga mësuesi;
  - mjete kancelarie, kompjuter ne lidhje me internetin;
  - formularë, pasqyra financiare, libra financiarë të detyrueshëm, të marra nga praktika ose përpunuar në modulet e mëparshme;
  - materiale të ndryshme informative.
-

## 6. Moduli: “Promocioni i produktit dhe i imazhit të strukturës hoteliere dhe turistike”

Drejtimi: Hoteleri-Turizëm  
Niveli: IV i KSHK  
Klasa: 13

### PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe Kodi	PROMOCIONI I PRODUKTIT DHE I IMAZHIT TË STRUKTURËS HOTELIERE DHE TURISTIKE	M-13-1660-20
Qëllimi i modulit	Një modul, që i pajis nxënësit me aftësi praktike për të kryer politikën e produktit të saj, të promocionit të imazhit të strukturës hoteliere e turistike dhe aplikime për pjesëmarrje në panaiere, hartimin e materialeve promovuese, si dhe kryerjen e veprimeve para gjatë dhe pas panairit.	
Kohëzgjatja e modulit	33 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për praninë	Nxënësit duhet të kenë përfunduar një nga profilet mësimore të nivelit të III të KSHK, të drejtimit mësimor Hoteleri-turizëm.	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	<b>RM 1 Nxënësi krijon figurën udhëheqëse të strukturës hoteliere dhe turistike.</b> <b>Kriteret e vlerësimit:</b> Nxënësi duhet të jetë i aftë: <ul style="list-style-type: none"><li>- të përshkruajë rëndësinë e zhvillimit të figurës udhëheqëse të një strukture hoteliere dhe turistike;</li><li>- të identifikojë vlerat e strukturës hoteliere dhe turistike në treg, nëpërmjet vëzhgimeve, pyetësorëve, anketimeve, diskutimeve, duke përshkruar mënyrën e të menduarit dhe të sjellurit ku bazohen marrëdhëniet me të.</li><li>- të identifikojë llojet e klientëve, ku është e orientuar struktura hoteliere dhe turistike.</li><li>- të identifikojë llojet e bashkëpunëtorëve dhe partnerët e strukturës hoteliere dhe turistike;</li><li>- të evidentojë pikat e forta dhe të dobëta të aktivitetit të biznesit.</li><li>- të krijojë një vizion për të ardhmen e strukturës hoteliere dhe turistike, duke përshkruar qartë dhe në mënyrë kreative tregun në të cilin ajo është e orientuar;</li><li>- të formulojë qartë qëllimet dhe objektivat, që synon biznesi në të ardhmen;</li><li>- të identifikojë, nëpërmjet metodave të ndryshme, kërkesat dhe shkallën e kënaqësisë së klientëve dhe bashkëpunëtorëve të strukturës hoteliere dhe turistike;</li><li>- të përshkruajë qëllimin e ekzistencës së biznesit;</li><li>- të formulojë misionin e strukturës hoteliere dhe turistike,</li></ul>	

---

duke u mbështetur në nevojat dhe llojet e klientëve që ajo u drejtohet, si dhe aktivitetet, teknologjitë dhe metodat e shitjeve që do të përdorë;

- të krijojë sloganin e strukturës hoteliere dhe turistike, duke u mbështetur në dobinë e produktit dhe shërbimin e klientëve;
- të ndërtojë përkufizimin e filozofisë së strukturës hoteliere dhe turistike, sipas besimeve, vlerave dhe kulturës së saj.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

**RM 2 Nxënësi koncepton dhe krijon logon e strukturës hoteliere dhe turistike.**

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë rëndësinë e konceptimit dhe krijimit të identitetit vizual të strukturës hoteliere dhe turistike;
- të kryejë identifikimin e pjesëve përbërëse të identitetit vizual të biznesit si; logoja, ngjyrat, forma etj.
- të përcaktojë kriteret për krijimin e logos sipas vlerave, misionit, filozofisë dhe karakteristikave të strukturës hoteliere dhe turistike;
- të përzgjedhë elementët dhe simbolet, që duhet të përmbajë logoja;
- të përcaktojë kriteret grafike të qarta dhe të thjeshta, që përmban logoja;
- të zbatojë teknikat krijuese të përzgjedhjes së ngjyrave, objekteve, formave, fotove, frazave, për ndërtimin e logos së strukturës hoteliere dhe turistike;
- të kryejë skicimin dhe konceptualizimin e idesë, për logon;
- të kryejë kombinimin e simboleve, fjalëve dhe ngjyrave;
- të artikulojë mesazhin që përcjell logoja, sipas natyrës së audiencës së synuar;
- të përzgjedhë krijimet e logove më të mira;
- të marrë vendimin përfundimtar, për logon e strukturës hoteliere dhe turistike;
- të krijojë logon e strukturës hoteliere dhe turistike, si simbol në mënyrë të që të dallohet dhe njihet lehtësisht nga kompanitë e tjera;
- të prezantojë logon e biznesit turistik.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

**RM 3 Nxënësi realizon reklamën e strukturën hoteliere dhe turistike dhe produktit të saj.**

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përcaktojë drejt grupin e synuar, në varësi të tregut të strukturës hoteliere dhe turistike;
- të hartojë një plan të qartë dhe të detajuar të masave, për

promovimin e strukturën hoteliere dhe turistike /produktit të saj;

- të hartojë formularë dhe dokumente me logon dhe ngjyrat me të cilat do të identifikohet struktura hoteliere dhe turistike gjatë veprimtarisë;
- të realizojë fletëpalosje, katalogë dhe materiale të tjera të shkruara për të promovuar strukturën hoteliere dhe turistike dhe produktin, duke përdorur teknika të ndryshme të animacionit në PC;
- të hartojë formate të korrespondencës zyrtare me elementet e identitetit dhe elementët e duhur formalë;
- të konceptojë veshjen e personelit në mënyrë të përshtatshme për prezantimin e tyre ndaj klientëve dhe mbarjen e imazhit të strukturës hoteliere dhe turistike;
- të konceptojë reklamat audiovizive me të cilat struktura hoteliere dhe turistike do të prezantohet.
- të përzgjedhë njërin nga teknikat e reklamimit, në përputhje me segmentimin e detajuar të tregut, për formulimin saktë të mesazhit të reklamës;
- të prezantojë, sipas rregullave, reklamën e krijuar.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

**RM 4 Nxënësi kryen veprime përgatitore për pjesëmarrjen në panair.**

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të hartojë kërkesën për pjesëmarrje në panair ;
- të dërgojë kërkesën tek organizatorët e panairit, të shoqëruar me informacionet e kërkuara për strukturën hoteliere dhe turistike;
- të hartojë sloganin me të cilin “firma” do të paraqitet në panair;
- të hartojë kontratat e shitblerjes që do të përdoren në panair;
- të hartojë pasqyrat e shpenzimeve sipas llojeve të tyre;
- të hartojë listën e materialeve të nevojshme për realizimin e pjesëmarrjes në panair;
- të ndajë detyrat dhe përgjegjësitë, duke përcaktuar afatet kohore të realizimit të tyre;
- të aplikojë për strukturën hoteliere dhe turistike, si pjesëmarrëse në panair, duke dërguar informacionet e duhura, që kërkohen nga organizatorët e panairit;
- të marrë njoftimin për pjesëmarrje në panair, së bashku me informacionin e vendodhjes së stendës së firmës, orarin e panairit, dokumentacionin e sigurimit të tij, listën e firmave pjesëmarrëse në panair;
- të kryejë studime në bazë të statistikave lidhur me shitjet dhe blerjet e realizuara në panairin e kaluar;
- të kontrollojë gjendjen e llogarisë rrjedhëse të “firmës”

- dhe personelit.
- të printojë dëftesat e lëvrimit dhe faturat për shitje, pasi i ka përgatitur ato;
  - të hartojë planin e ndërtimit të stendës së panairit;
  - të përgatisë prezantimet elektronike ose reklammat filmike për panair;
  - të sigurojë veshjet e nxënësve për panairin, në përshtatje me identitetin e strukturës hoteliere dhe turistike dhe produktit;
  - të përpunojë materiale të shkruara informative (katalogë, fletëpalosje, oferta speciale për panair, kartvizita, etj);
  - të printojë materialet informative të përpunuara për panair;
  - të përcaktojë personat përgjegjës dhe detyrat e tyre gjatë panairit;
  - të planifikojë bisedat e shitjes për panair.
- Instrumentet e vlerësimit:***
- Vëzhgim me listë kontrolli.

#### **RM 5 Nxënësi kryen veprime gjatë panairit.**

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të regjistrojë strukturën hoteliere dhe turistike në zyrën e informacionit të panairit;
- të firmosë rregulloren e panairit;
- të marrë në dorëzim materialet e porositura tek organizatorët e panairit;
- të marrë në dorëzim kartat e kreditit për blerje me para në dorë;
- të ndërtojë stendën, sipas detyrave të paracaktuara;
- të vendosë materialet reklamuese në stendë;
- të përgatisë tavolinën e prezantimit, gjatë punës në panair;
- të mirëmbajë mjedisin e stendës gjatë panairit;
- të promovojë strukturën hoteliere e turistike dhe aktivitetin e saj në stendë, nëpërmjet materialeve materialeve të shkruara informative dhe prezantimeve elektronike.
- të promovojë ndërmarrjen dhe aktivitetin e saj në sallën e panairit, nëpërmjet bisedave për shitje, reklamimit dhe dhuratave për pjesëmarrësit;
- të lidhë kontrata për blerje dhe shitje për peridha të ardhshme;
- të kryejë blerje për strukturën hoteliere e turistike dhe personelin me pagesë të mëvonshme dhe karta krediti;
- të kryejë shitjet për personelin dhe vizitorët me arkëtim të mëvonshëm e karta krediti, duke hartuar DL (dëftesa lëvrimi) dhe faturat përkatëse;
- të plotësojë formularin përmbledhës të shitjeve të realizuara në panair;
- të dorëzojë formularin e shitjeve në bankën e firmave.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

## RM 6 Nxënësi kryen veprime pas panairit.

### *Kriteret e vlerësimit:*

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të regjistrojë saktë blerjet dhe shitjet në librat kontabël përkatës;
- të regjistrojë hyrjet dhe daljet e produkteve në kartelat e magazinës;
- të kryejë porositë eventuale të firmës korrespondente për kryerjen e blerjeve;
- të kryejë procedurat e marrjes në dorëzim dhe dokumentimit të mallrave të porositura;
- të hartojë saktë UXH për blerjet e mëvonshme
- të regjistrojë arkëtimet për shitjet me karta krediti në librat kontabël përkatës;
- të regjistrojë arkëtimet eventuale për shitjet me arkëtim të mëvonshëm në librat kontabël përkatës;
- të llogarisë rezultatit e veprimeve të kryera gjatë panairit;
- të hartojë saktë statistikën, lidhur me shitjet e panairit;
- të analizojë shitjet në panair, krahasuar me shitjet e realizuara në panairin pararendës.

### *Instrumentet e vlerësimit:*

- Vëzhgim me listë kontrolli.

---

### **Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve.**

- Ky modul duhet të trajtohet në mjediset e firmave ushtrimore.
- Trajtimi i këtij moduli duhet të shtrihet gjatë gjithë vitit shkollor. Ai duhet të zhvillohet paralelisht me module të tjera.
- Mësuesi i praktikës duhet të nxisë aftësitë krijuese të nxënësve duke i nxitur për përdorimin e burimeve të ndryshme të informimit, për një bashkëpunim sa më të mirë me njëri-tjetrin, për realizimin e promovimit të imazhit të strukturës hoteliere e turistike dhe reklamës së produktit.
- Mësuesi i praktikës këshillohet të përdorë edhe materiale filmike të panairëve të ndërmarrjeve ose dhe të panairëve të FU-ve të viteve të kaluara.
- Mësuesi i praktikës mund të organizojë vizita në panair të ndërmarrjeve reale, si një përvojë që u vjen në ndihmë nxënësve.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për përgatitjen e standave, të materialeve të shkruara, të reklamës dhe promovimit, për kryerjen e veprimeve dhe bisedave të shitjes në panair si dhe veprimeve të nevojshme pas panairit.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e politikës së produktit, reklamës për strukturën hoteliere e turistike dhe produktin, si dhe përgatitjen dhe prezantimin e FU-së në panair. Përgatitja për panair planifikohet dhe relizohet nga e gjithë klasa.

---

### **Kushtet e domosdoshme**

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:

---

---

**për realizimin e  
modulit**

- mjediset e firmave ushtrimore;
  - mjete kancelarie;
  - fletëpalosje dhe materiale të ndryshme reklame të marra në ndërmarrje të ndryshme;
  - statistika të panairove të mëparshme të përpunuara nga nxënës të viteve të kaluara;
  - materiale të ndryshme audiovizuale, foto, filma që ilustrojnë paraqitje në panairove të mëparshme,;
  - kompiutera me programe të ndryshme animimi dhe të përpunimeve grafike;
  - lidhje interneti.
-